



Ne përputhje me dispozitat e nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 02/2013

SHUMA E TATUESHME NË FURNIZIMET ME TVSH PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

QËLLIMI

Ky Vendim Shpjegues Publik rregullon trajtimin për çështje tatimore nga aspekti i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve, të realizuara nga Ndërmarrjet Publike (NP).

Duke ditur se:

Bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, të datës 29 Dhjetor 2009, secila Ndërmarrje Publike është e obliguar të paguaj TVSh-në, bazuar në konsideratën totale që duhet paguar për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, citojmë:

Neni 24 - Shuma e tatueshme për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve

"1. Rregulla e përgjithshme:

1.1. në lidhje me furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, ndryshe nga ajo që është referuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, shuma e tatueshme duhet të përfshijë çdo gjë që përbën konsideratën e marrë ose që do të merret nga furnizuesi, në kthim për furnizimin nga konsumatori apo pala e tretë, duke përfshirë këtu subvencionet e lidhura direkt me çmimin e furnizimit".

Duke pasur parasyshë momentet vijuese:

- Shumë Ndërmarrje Publike vazhdojnë të kenë probleme financiare si pasojë e pamundësisë së inkasimit të kërkesave që rezultojnë nga furnizimet e mallrave apo shërbimeve të faturuara.
- Ndërmarrjet Publike ofrojnë shërbime jetike për qytetarët e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës e kupton rëndësinë e mbijetesës ekonomike të vazhdueshme të Ndërmarrjeve Publike, për sigurinë, shëndetin dhe jetën e qytetarëve të Kosovës;
- Nevojën për të baraspeshuar mandatin e ATK-së në sigurimin e të hyrave tatimore;
- Rëndësinë që të ruhet edhe më tutje aftësia financiare dhe afariste e Ndërmarrjeve Publike, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët me qëllim që t'u jepet kohë Ndërmarrjeve Publike që në mënyrë sa më të mirë t'i përmbushin në tërësi obligimet e tyre tatimore mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, në të ardhmën.

VENDIMI

Duke pasur parasysh arësyet dhe autoritetin ligjor të cekur më lartë, në përputhje me Nenin 3, paragrafin 3.8 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, mbi bazën e autorizimit për të hyrë në marrëveshje me Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Lokale, për të shtyrë mbledhjen e detyrueshme të tatimeve, me qëllim të ndihmës në procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Publike apo për të ofruar vazhdimësi të veprimtarisë së tyre, ka vendosur që:

Trajtimi i Ndërmarrjeve Publike, të cilat kanë vështërsi financiare dhe të cilat arrijnë të lidhin një marrëveshje me ATK-në, nga aspekti i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (në lidhje me shumën e tatueshme) të deklarojnë dhe paguajnë sipas këtij Vendimi Shpjegues Publik.

NDËRMARRJET PUBLIKE – SUBJEKTE TË KËTIJ VENDIMI SHPJEGUES PUBLIK

Subjekte të këtij Vendim Shpjegues Publik mund të jenë të gjitha Ndërmarrjet Publike, përveç:

- Postë dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK);
- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK);
- Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB).

Ndërmarrjet Publike të cilat plotësojnë kriteret që dëshmojnë vështërsi financiare, dhe dëshirojnë të deklarojnë dhe paguajnë TVSh sipas këtij Vendimi Shpjegues Publik, kërkohet që të marrin miratim nga Administrata Tatimore e Kosovës, për të hyrë në marrëveshje siç specifikohet me Nenin 5, nënparagrafin 2.2.2.4, të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010, citojmë:

“2.2.2.4 kur detyrimi lidhet me Tatimin në Vlerën e Shtuar (në vijim TVSh), Drejtori i Përgjithshëm, mund të zvogëlojë detyrimin tatimor, kur NP nuk është në gjendje të mbledhë TVSh nga shumat e faturuara për konsumatorët. Në këto raste, Drejtori i Përgjithshëm, pranon t'i mundësojë NP, pagesën e TVSh vetëm deri në shkallën e inkasimit. Edhe në këto raste, Drejtori i Përgjithshëm, do të bëjë marrëveshjet vetëm për një periudhë deri në 18 muaj, në fund të së cilës NP, detyrimisht duhet të zbatojë dispozitat e borxhit të keq (e parashikuar në Ligjin për TVSh-në, por duke ju referuar ndryshimeve për qëllime të këtij neni), për të ulur detyrimin e vet të TVSh, në ato raste në të cilat, konsumatorët nuk paguajnë faturat e tyre”

IMPLEMENTIMI

Implementimi i Marrëveshjes në mes të Ndërmarrjes Publike dhe ATK-së, sipas këtij Vendimi Shpjegues Publik, do të bëhet si në vijim:

- Shuma e faturuar dhe e pa-inkasuar do të deklarohet në rubrikën:
[10] Furnizimet e trajtuara si eksporte me të drejtë kreditimi
- Shuma e inkasuar do të deklarohet në rubrikën:
[12] Shitjet e tatueshme me normën 16%

Shembull për ilustrim:

- Shuma e faturimit të një personi të tatueshëm 25,000€
- Shuma e inkasuar 20,000€
- Blerjet e tatueshme vendore 10,000€

Duke iu referuar të dhënave më lartë, sipas Ligjit Nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, deklarata tatimore e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar do të dukej si në vijim:

[12] Shitjet e tatueshme me normën 16%	25,000€	
[13] TVSh e llogaritur		4,000€
[31] Blerjet e tatueshme vendore	10,000€	
[32] TVSh e zbritshme		1,600€
[48] TVSh që duhet të paguhet		2,400€

Ndërsa duke iu referuar të dhënave më lartë, sipas këtij Vendimi Shpjegues Publik, deklarata tatimore e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar do të dukej si në vijim:

[10] Furnizimet e trajtuara si eksporte me të drejtë kreditimi	5,000€
[12] Shitjet e tatueshme me normën 16%	20,000€
[13] TVSh e llogaritur (20,000*16%)	3.200€
[31] Blerjet e tatueshme vendore	10,000€
[32] TVSh e zbritshme	1,600€
[48] TVSh që duhet të paguhet (3,200-1,600)	1,600€

Data: 16/10/2013
Prishtinë,

z. Behxhet Haliti

Drejtor i Përgjithshëm ATK-së

